

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 142/2 Prot.

Vlorë më, 16.01.2024

VENDIM

Nr. 2, datë 16.01.2024  
PËR

PËR DISA NDRYSHIME/ SHTESA NË VENDIMIN NR. 75, DATË 13.07.2017, TË  
SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM-së nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar", dhe "Profesor"si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimi Institucional ardhur me shkresë nr.2045, prot, datë 03.11.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.01.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Instiucional si më poshtë:


Ndryshimin e pikës 1 gërma a e cila:


**Ishte:** Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së në mënyrë të barabartë për vitin kalendarik 2017.

**Bëhet:** Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së (vetëm stafit akademik me kohë të plotë dhe që mban minimumi gradën shkencore Doktor Shkencash – Dr.) sipas kërkesave të tyre. Kjo shumë nuk mund të kalojë vlerën e 120.000 lekë për vit akademik.

Ndryshimin e pikës 1 gërma b e cila:

**Ishte:** Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e fee-s (tarifës) së konferencës/botime/pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit. Kjo shumë nuk mund të shpenzohet më shumë se në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime brenda Shqipërisë (vetëm në ato tek lista e revistave që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime në revista të BE-s, OECDsë dhe G-20.\*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

**Bëhet:** Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e fee-s (tarifës) së konferencës/botime/pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit. Kjo shumë të shpenzohet deri në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime shkencore brenda Shqipërisë (vetëm në revistat që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë dhe miratojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime shkencore në revista të BE-s, OECD-së dhe G-20.

Shfuqëzimin e pikës 1, gërma c.

Paralelisht të shtohen:

Pika 2:

- a. Secili pedagog ka të drejtë të kërkojë rimbursim gjatë vitit akademik deri në vlerën 120.000 lekë.
- b. Financohen vetëm artikuj shkencor të cilat janë të indeksuara në Journal Citation Reports edhe/ose Scopus;
- c. Publikime shkencore në revista të cilat në momentin e kërkesës së rimbursimit nuk janë të indeksuara, nuk mund të rimbursohen;
- d. Nuk financohen pjesmarrje në konferenca të cilat nuk kanë abstract book të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
- e. Pedagogët të cilët kërkojnë rimbursim janë të detyruar të dorëzojnë të dhënat e përdorura/mbledhura (në raste se ka) pranë Njesisë Bazë si dhe pranë data repository të UV-së. Kjo nuk ndodh vetëm në raste ku të dhënat janë konfidenciale ose janë depozituar në depozita të dhënash të tjera jashtë Shqipërisë. Pavarësisht kësaj më lart, pedagogët janë të detyruar të raportojnë për disponibilitetin e të dhënave;
- f. Nuk financohen botime/artikuj shkencor në aktivitete shkencore/revista shkencore të publikuara në gjuhën shqipe jashtë Shqipërisë;
- g. Nuk financohen botime në revista shkencore multidisiplinore;
- h. Nuk financohen botime në konferenca multidisiplinore;

Nga pika f e përmendur më lart, përjashtohen pedagogët e Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë të cilët mund të publikojnë dhe të rimbursohen për punime shkencore të publikuara në Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut.

Tek sektori "*Detyrimet e përfituesve të fondit*" të ndryshohet pika 3:

**Ishte:** Të kenë informuar të paktën 2 (dy) muaj para organizimit të konferencës (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e fee-s dhe biletave me vlerë sa më të ulët).

**Bëhet:** Pedagogët janë të detyruar të regjistrohen në momentin më të hershëm të mundshëm në konferencën në të cilën do të marrin pjesë. Nuk do të lejohet rimbursimi për regjistrim në





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

momentin e fundit (late registration). Në rast se kërkohet mbulimi i shpenzimeve të transportit si dhe të akomodimit, aplikantët duhet të bëjnë kërkesën e tyre për autorizim sa më shpejt të jetë e mundur si dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore të parashikuara.

Tek sektori "*Detyrimet e përfituesve të fondit*" të shfuqizohet pika 4.

Tek sektori "*Detyrimet e përfituesve të fondit*" të shtohen:

- Pedagogët që marrin rimbursim nga UV janë të detyruar që një kopje të artikullit/punimit shkencor/abstrakt-it ta dorëzojnë pranë Njesisë Bazë si dhe Biblotekës së UV-së brenda 20 ditëve nga momenti i publikimit;
- Mos përdorimi i email-it zyrtar dhe i affiliation të UV përjashton personat nga rimbursimi;
- Është e nevojshme/sugjerueshme përfshirja e një seksioni "mirënjohje" (acknowledgement) tek punimi shkencor për financuesin e punimit;
- Është e nevojshme/sugjerueshme përfshirja e logos së UV-së në rastet e prezantimit të punimeve shkencore në aktivitete të ndryshme shkencore (konferenca, simpoziume, workshope etj.);
- Pjesëmarrja me postera në konferenca nuk rimbursohet;

Tek sektori "*Nga përfitimi i këtij fondi përjashtohen*" të shfuqizohet pika 2.

Shfuqizimin e sektorit "*Përfitimet*".

Të shtohet një seksion me emrin "**Promovimi Akademik**"


Me qëllim mbështetjen e personelit akademik për promovimin e tij akademik, është e mundur rimbursimi i pagesës së faturës deri në masën 70%. Në rastin që personeli akademik kërkon pagesën e faturës për promovimin e tij akademik, humbet të drejtën për rimbursim të shpenzimeve për pjesëmarrje në konferenca ose publikim artikulli shkencor.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Administratori, si dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.Asoc. Xhiliola Agaraj (Shehu)**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI SHTETËROR I "ISMAIL QEMALI" VLORE

ZV/REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 2045 Prot.

Vlorë, më 03 / 11 / 2023

**Lënda:** Për disa ndryshime/shtesa në vendimin Nr. 75, datë 13.07.2017 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë

**PROF. DR. ROLAND ZISI**  
**REKTOR I UV-SË**

**KËTU:**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, shkronja c, nenit 38, pika 1, shkronja k në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" si dhe të VKM-së Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" propozoj disa ndryshime/shtesa në vendimin Nr. 75, datë 13.07.2017 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

Ndryshimin e pikës 1 gërma a e cila:

**Ishte:** Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së në mënyrë të barabartë për vitin kalendarik 2017.

**Bëhet:** Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së (vetëm stafit akademik me kohë të plotë dhe që mban minimumi gradën shkencore Doktor Shkencash – Dr.) sipas kërkesave të tyre. Kjo shumë nuk mund të kaloj vlerën e 120.000 lek për vit akademik. Shuma mund të ndryshoj në bazë dhe të nevojave dhe/ose rasteve specifike.



Ndryshimin e pikës 1 gërma b e cila:

**Ishte:** Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e fee-s (tarifës) së konferencës/botime/pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit. Kjo shumë nuk mund të shpenzohet më shumë se në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime brenda Shqipërisë (vetëm në ato tek lista e revistave që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime në revista të BE-s, OECD-së dhe G-20.\*

**Bëhet:** Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e fee-s (tarifës) së konferencës/botime/pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit. Kjo shumë të shpenzohet deri në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime shkencore brenda Shqipërisë (vetëm në revistat që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë dhe miratojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime shkencore në revista të BE-s, OECD-së dhe G-20.

Shfuqëzimin e pikës 1, gërma c.

Paralelisht propozohet të shtohen:

Pika 2:

- a. Secili pedagog ka të drejt vetëm 1 herë në vit (vit akademik) të kërkoj rimbursim;
- b. Financohen vetëm artikuj shkencor të cilat janë të indeksuara në Journal Citation Reports edhe/ose Scopus;
- c. Publikime shkencore në revista të cilat në momentin e kërkesës së rimbursimit nuk janë të indeksuara, nuk mund të rimbursohen;
- d. Nuk financohen pjesmarrje në konferenca të cilat nuk kanë abstract book të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
- e. Pedagogët të cilët kërkojnë rimbursim janë të detyruar të dorëzojnë të dhënat e përdorura/mbledhura (në raste se ka) pranë Njesisë Bazë si dhe pranë data repository të UV-së. Kjo nuk ndodh vetëm në raste ku të dhënat janë konfidenciale ose janë depozituar



ZV/REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

në depozita të dhënash të tjera jashtë Shqipërisë. Pavarësisht kësaj më lart, pedagogët janë të detyruar të raportojnë për disponibilitetin e të dhënave;

- f. Nuk financohen botime/artikuj shkencor në aktivitete shkencore/revista shkencore të publikuara në gjuhën shqipe jashtë Shqipërisë;
- g. Nuk financohen botime në revista shkencore multidisiplinore;
- h. Nuk financohen botime në konferenca multidisiplinore;

Nga pika f e përmendur më lart, përjashtohen pedagogët e Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë të cilët mund të publikojnë dhe të rimbursohen për punime shkencore të publikuara në Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut.

Tek sektori "*Detyrimet e përfituesve të fondit*" propozohet të ndryshohet pika 3:

Ishte: Të kenë informuar të paktën 2 (dy) muaj para organizimit të konferencës (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e fee-s dhe biletave me vlerë sa më të ulët).

Bëhet: Pedagogët janë të detyruar të regjistrohen në momentin më të hershëm të mundshëm në konferencën në të cilën do të marrin pjesë. Nuk do të lejohet rimbursimi për regjistrim në momentin e fundit (late registration). Në rast se kërkohet mbulimi i shpenzimeve të transportit si dhe të akomodimit, aplikantët duhet të bëjnë kërkesën e tyre sa më shpejt të jetë e mundshme si dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjiore të parashikuara.

Tek sektori "*Detyrimet e përfituesve të fondit*" propozohet të shfuqëzohet pika 4.

Tek sektori "*Detyrimet e përfituesve të fondit*" propozohet të shtohen:

- Pedagogët që marrin rimbursim nga UV janë të detyruar që një kopje të artikullit/punimit shkencor/abstract-it ta dorëzojnë pranë Njesisë Bazë si dhe Bibliotekës së UV-së brenda 20 ditëve nga momenti i publikimit;
- Mos përdorimi i email-it zyrtar dhe i affiliation të UV përjashton personat nga rimbursimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

ZV/REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

- Është e nevojshme/sugjerueshme përfshirja e një seskioni "mirënjohje" (acknowledgement) tek punimi shkencor për financuesin e punimit;
- Është e nevojshme/sugjerueshme përfshirja e logos së UV-së në rastet e prezantimit të punimeve shkencore në aktivitete të ndryshme shkencore (konferenca, simpoziume, workshope etj.);
- Pjesmarrja me postera në konferenca nuk rimbursohet;

Tek sektori "*Nga përfitimi i këtij fondi përjashtohen*" propozohet të shfuqëzohet **pika 2**.


Shfuqizimin e sektorit "*Përfitimet*".

Propozohet të shtohet një seksion me emrin "Promovimi Akademik"

Me qëllim mbështetjen e personelit akademik për promovimin e tij akademik, është e mundur rimbursimi i pagesës së faturës deri në masën 70%. Në rastin që personeli akademik kërkon pagesën e faturës për promovimin e tij akademik, humbet të drejtën për rimbursim të shpenzimeve për pjesmarrje në konferenca ose publikim artikulli shkencor.

Ju faleminderit për bashkpunimin!

ZV. REKTOR  
PROF. ASOC. ENKELEJD MËHILLI



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORI

Vlorë më, 03.11.2023

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektori
- Këshilli Etikës
- Rektori
  - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
  - Sektori Juridik
  - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
    - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
    - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
    - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
  - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
  - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
  - Sektori i Prokurimeve
  - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
  - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
  - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
  - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
  - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
  - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekes Shkencore
  
- Prof. Asoc. Aurela Saliq      Dekan F.SH.
  - Kryesekretare                      F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri      Dekan F.E.
  - Kryesekretare                      F.E.
- Prof. As. Armela Panajoti      Dekan F.SH.H.
  - Kryesekretare                      F.SH.H.
- Prof.As. Hajdar Kicaj      Dekan F.SH.T.N.
  - Kryesekretare                      F.SH.T.N.

REKTORI  
Prof. Dr. Roland ZISI